REPUBLIKA E KOSOVËS - РЕПУБЛИКА КОСОВО - REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA KUSHTETUESE
УСТАВНИ СУД
CONSTITUTIONAL COURT

Prishtinë, më 6 mars 2019
Nr. ref.:RK 1332/19

AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI

në

rastin nr. KI85/18

Parashtrues

Baki Gashi

Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Supreme të Kosovës, PML. nr. 208/2017, të 29 janarit 2018

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Arta Rama-Hajrizi, kryetare
Bajram Ljatifi, zëvendëskryetar
Bekim Sejdiu, gjyqtar
Selvete Gërxhaliu-Krasniqi, gjyqtare
Gresa Caka-Nimani, gjyqtare
Safet Hoxha, gjyqtar
Radomir Laban, gjyqtar
Remzije Istrefi-Peci, gjyqtare dhe
Nexhmi Rexhepi, gjyqtar

Parashtruesi i kërkesës

1. Kërkesa është parashtruar nga Baki Gashi, nga Podujeva (në tekstin e mëtejmë: parashtruesi i kërkesës), të cilin e përfaqëson avokati Namon Merovci.

Vendimi i kontestuar

2. Parashtruesi i kërkesës konteston kushtetutshmërinë e Aktgjykimit të Gjykatës Supreme të Kosovës, PML. nr. 208/2017 (në tekstin e mëtejmë: Gjykata Supreme), të 29 janarit 2018, të cilin e ka pranuar më 14 shkurt 2018.

Objekti i çështjes

3. Objekt i çështjes është vlerësimi i kushtetutshmërisë së aktgjykimit të kontestuar, me të cilin parashtruesi i kërkesës pretendon shkeljen e të drejtave të tij të garantuara me nenet: 3 [Barazia para Ligjit], 29 [E Drejta e Lirisë dhe Sigurisë], 30 [Të Drejtat e të Akuzuarit] dhe 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Kushtetuta).

Baza juridike

4. Kërkesa bazohet në paragrafët 1 dhe 7, të nenit 113 [Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara] të Kushtetutës, në nenin 22 [Procedimi i kërkesës] dhe 47 [Kërkesat Individuale] të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, nr. 03/L-121 (në tekstin e mëtejmë: Ligji) dhe në rregullin 32 [Parashtrimi i kërkesave dhe përgjigjeve] të Rregullores së punës së Gjykatës Kushtetuese (në tekstin e mëtejmë: Rregullorja e punës).

5. Më 31 maj 2018, Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Gjykata), miratoi në seancën administrative plotësim-ndryshimin e Rregullores së punës, e cila u publikua në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës, më 21 qershor 2018 dhe hyri në fuqi 15 (pesëmbëdhjetë) ditë pas publikimit të saj. Rrjedhimisht, Gjykata tani i referohet dispozitave të rregullores së re në fuqi.

Procedura në Gjykatë

6. Më 14 qershor 2018, parashtruesi e dorëzoi kërkesën në Gjykatë.

7. Më 16 gusht 2018, Kryetarja e Gjykatës caktoi gjyqtarin Radomir Laban gjyqtar raportues dhe Kolegjin shqyrtues, të përbërë nga gjyqtarët: Gresa Caka-Nimani (kryesuese), Bajram Ljatifi dhe Safet Hoxha.

8. Më 30 gusht 2018, Gjykata njoftoi parashtruesin për regjistrimin e kërkesës dhe i dërgoi një kopje të kërkesës Gjykatës Supreme.

9. Më 24 tetor 2018, Gjykata kërkoi informata shtesë nga Gjykata Themelore në Mitrovicë, përkitazi me datën e dorëzimit të aktgjykimit të kontestuar.

10. Më 27 nëntor 2018, Gjykata për herë të dytë rikërkoi informata shtesë nga Gjykata Themelore në Mitrovicë, përkitazi me datën e dorëzimit të aktgjykimit të kontestuar.

11. Më 12 dhjetor 2018, Gjykata Themelore në Mitrovicë, informoi Gjykatën që parashtruesit të kërkesës i është dorëzuar aktgjykimi i kontestuar, më 14 shkurt 2018.

12. Më 30 janar 2019, Kolegji shqyrtues e shqyrtoi raportin e gjyqtarit raportues dhe njëzëri i rekomandoi Gjykatës papranueshmërinë e kërkesës.

Përmbledhja e fakteve

13. Më 24 korrik 2014, Prokuroria Themelore në Mitrovicë - Departamenti për Krime të rënda, ngriti aktakuzën PPl. nr. 77/2614, ndaj parashtruesit të kërkesës dhe 5 (pesë) të akuzuarve të tjerë, për kryerjen e veprave penale, nga neni 327, paragrafi 2, pika 2.1, 2.6 dhe 2.7, në lidhje me nenin 31 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: KPRK).

14. Më 30 gusht 2016, Gjykata Themelore në Mitrovicë - dega në Skenderaj (në tekstin e mëtejmë: Gjykata Themelore), me Aktgjykimin P. nr. 71/2015, shpalli parashtruesin e kërkesës fajtor për kryerjen e veprës penale, nga neni 327, paragrafi 2, pika 2.7, në lidhje me nenin 31 të KPRK-në. Në aktgjykimin e saj, Gjykata arsyetoi: *"... duke u bazuar në dispozitat ligjore nga neni 361 të KPP-së me ndërgjegje i vlerësoi një nga një dhe në lidhje me provat tjera dhe në bazë të vlerësimit të tillë e vërtetoi se të pandehurit janë kryerës të veprave penale për të cilat ata akuzohen".*

15. Parashtruesi i kërkesës paraqiti ankesë në Gjykatën e Apelit kundër Aktgjykimit të Gjykatës Themelore, P. nr. 71/2015, duke pretenduar se Aktgjykimi i Gjykatës Themelore është nxjerrë në vërtetim të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe shkelje esenciale të dispozitave të ligjit material dhe procedural. Kundër aktgjykimit në fjalë, ankesë kishte parashtruar dhe Prokurori i Prokurorisë Themelore, për shkak të vendimit mbi dënimin, me propozimin që Gjykata e Apelit ta ndryshoj aktgjykimin dhe të akuzuarve t'iu shqiptoj dënim me burg efektivë me të lartë.

16. Më 21 mars 2017, Gjykata e Apelit, me Aktgjykimin PAl. nr. 1428/16, i refuzoi si të pabazuara ankesat e parashtruesit të kërkesës dhe të Prokurorit Publik, dhe vërtetoi Aktgjykimin e Gjykatës Themelore, duke arsyetuar:

> *"Gjykata e Apelit, pretendimet e mbrojtësve të të akuzuarve, sa i përket kësaj baze ankimore i vlerëson si të pabazuara, meqë gjykata e shkallës së parë për vërtetimin e plotë dhe të drejtë të gjendjes faktike ka administruar të gjitha provat e propozuara dhe ka bërë vlerësimin e tyre konform dispozitave ligjore nga neni 361 të KPPK-së, (...). Se të akuzuarit kanë vepruar si grup i organizuar kriminal kjo vërtetohet nga fakti se të njëjtit kanë vepruar brenda një kohe të caktuar dhe në hapësirë prej datës 25.05.2013 deri me datë 05.04.2014, grupi ka pasur 6 anëtarë të cilët kanë vepruar në qëllim të kryerjes së veprave penale të vjedhjes së rëndë në nëntë raste të veçanta brenda një territori të caktuar për përfitime financiare dhe materiale, ... kurse i akuzuari B. G. kishte kryer rolin e transportuesit të kafshëve të vjedhura nga shtëpia e të dëmtuarit M. A. (...)".*

17. Në një datë të pasaktësuar, parashtruesi i kërkesës parashtroi kërkesë për mbrojtje të ligjshmërisë në Gjykatën Supreme, me pretendimin se gjykatat e instancave më të ulëta bënë shkelje thelbësore të dispozitave të së drejtës procedurale dhe materiale dhe gabimisht vërtetuan gjendjen faktike.

18. Më 29 janar 2018, Gjykata Supreme, me Aktgjykimin PML. nr. 208/2018, refuzoi si të pabazuar kërkesën për mbrojtjen e ligjshmërisë së parashtruesit të kërkesës, dhe vërtetoi aktgjykimet e gjykatës së shkallës së parë dhe të dytë, me arsyetimin se mbrojtësit e të dënuarve nuk precizuan kërkesën e tyre për shkeljet eventuale të ligjit penal.

Pretendimet e parashtruesit të kërkesës

19. Parashtruesi i kërkesës pretendon se vendimet e gjykatave të rregullta janë nxjerrë me shkelje të nenit 31 të KPPK-së, dhe si rrjedhojë e këtyre shkeljeve të ligjit erdhi deri të shkelja e të drejtave të parashtruesit të kërkesës të garantuara me nenet: 3, 29, 30 dhe 31 të Kushtetutës.

20. Parashtruesi i kërkesës konsideron se gjykatat e rregullta gabimisht interpretuan nenin 31 të KPPK-së, si dhe gabimisht vërtetuan gjendjen faktike dhe kanë bazuar vendimet e tyre vetëm në një provë të vetme. Parashtruesi i kërkesës i arsyeton këto pretendime si në vijim:

"Në rastin konkret është shkelur neni 31 i KPRK-së, ngase për t'u konsideruar se është kryer vepra penale në bashkëkryerje duhet të ekzistojë marrëveshja paraprake për shkaktimin e pasojës së ndaluar, e me këtë rast, si në procedurën paraprake, ashtu edhe në të gjitha fazat e shqyrtimit gjyqësor, bashkë të akuzuarit kanë deklaruar se nuk e njohin tani të dënuarin Baki Gashi. Njëherit, edhe të dëmtuarit që janë deklaruar në cilësi të dëshmitarit kanë deklaruar se as ata nuk e njohin tani të dënuarin Baki Gashi".

21. Për më tepër, parashtruesi i kërkesës i është drejtuar Gjykatës me kërkesën vijuese: "*... kërkojmë që kjo çështje penale të kthehet në rigjykim dhe rivendosje për të dënuarin B. G., dhe i njëjti të shpallet i pafajshëm. Kjo nga fakti se vendimi gjyqësor është mbështetur në një provë dhe pa i ndërlidhur ato me prova të tjera*".

Pranueshmëria e kërkesës

22. Gjykata shqyrton nëse parashtruesi i kërkesës i ka përmbushur kriteret e pranueshmërisë, të përcaktuara me Kushtetutë, të specifikuara më tej me Ligj dhe të parapara me Rregullore të punës.

23. Në këtë drejtim, Gjykata i referohet paragrafëve 1 dhe 7, të nenit 113 [Jurisdiksioni dhe Palët e Autorizuara] të Kushtetutës, që përcaktojnë:

"Gjykata Kushtetuese vendos vetëm për rastet e ngritura para gjykatës në mënyrë ligjore nga pala e autorizuar.

[...]

7. *Individët janë të autorizuar të ngrenë shkeljet nga autoritetet publike të të drejtave dhe lirive të tyre individuale, të garantuara me Kushtetutë, mirëpo vetëm pasi të kenë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj.*

[...]".

24. Gjykata gjithashtu shqyrton nëse parashtruesi i kërkesës ka përmbushur kriteret e pranueshmërisë të përcaktuara me nenet 48 [Saktësimi i kërkesës] dhe 49 [Afatet] të Ligjit, që përcaktojnë:

Neni 48
[Saktësimi i kërkesës]

"Parashtruesi i kërkesës ka për detyrë që në kërkesën e tij të qartësoj saktësisht se cilat të drejta dhe liri pretendon se i janë cenuar dhe cili është akti konkret i autoritetit publik të cilin parashtruesi dëshiron ta kontestojë".

Neni 49
[Afatet]

"Kërkesa parashtrohet brenda afatit prej katër (4) muajsh. Afati fillon të ecë që nga dita kur parashtruesit i është dorëzuar vendimi gjyqësor...".

25. Sa i përket plotësimit të këtyre kritereve, Gjykata konstaton se parashtruesi i kërkesës ka paraqitur kërkesë në cilësinë e palës së autorizuar, duke kontestuar aktin e autoritetit publik, përkatësisht Aktgjykimin e Gjykatës Supreme, PML. nr. 208/2017, pasi kishte shterur të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj. Parashtruesi i kërkesës gjithashtu paraqiti kërkesë në pajtim me afatin e paraparë në nenin 49 të Ligjit.

26. Megjithatë, Gjykata gjithashtu shqyrton nëse parashtruesi i kërkesës i ka përmbushur kriteret e pranueshmërisë, të përcaktuara me rregullin 39 (2) të Rregullores së punës, që përcakton:

"(2) Gjykata mund ta konsiderojë kërkesën të papranueshme, nëse kërkesa është qartazi e pabazuar, sepse parashtruesi nuk dëshmon dhe mbështetë në mënyrë të mjaftueshme pretendimin e tij".

27. Gjykata rikujton se parashtruesi i kërkesës pretendon shkeljen e të drejtave të tij të garantuara me nenin 3 [Barazia para Ligjit], 29 [E Drejta e Lirisë dhe Sigurisë], 30 [Të Drejtat e të Akuzuarit] dhe 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] të Kushtetutës, të cilat i ndërlidhë me nenin 31 të KPRK-së nen i cili flet për kryerjen e veprës penale "në bashkëkryerje" dhe faktin se gjykatat i bazuan vendimet e tyre në gjendjen faktike të vërtetuar gabimisht.

28. Në të vërtetë, Gjykata vëren se të gjitha pretendimet e parashtruesit të kërkesës janë të bazuara në ligjshmëri dhe jo në kushtetutshmëri, sepse ato kanë të bëjnë kryesisht me vërtetimin e gjendjes faktike, administrimin e provave dhe aplikimin e të drejtës procedurale dhe materiale. (shih, Gjykata Kushtetuese,

Aktvendimi për papranueshmëri, në rastin KI114/17, parashtrues *Albert Hadri,* të 22 shkurtit 2018, paragrafi 31).

29. Në këtë drejtim, Gjykata rithekson se nuk është detyrë e saj të merret me gabimet e faktit dhe të ligjit që pretendohet të jenë bërë nga gjykatat e rregullta me rastin e vlerësimit të provave ose aplikimit të ligjit (ligjshmërisë), përveç dhe për aq sa gabimet e tilla mund të kenë shkelur të drejtat dhe liritë e mbrojtura me Kushtetutë (kushtetutshmëria). Ajo vetë nuk mund të vlerësojë ligjin që ka bërë që një gjykatë e rregullt të miratojë një vendim në vend të një vendimi tjetër. Nëse do të ishte ndryshe, Gjykata do të vepronte si gjykatë e "shkallës së katërt", që do të rezultonte në tejkalimin e kufijve të vendosur në juridiksionin e saj.

30. Në të vërtetë, është roli i gjykatave të rregullta t'i interpretojnë dhe zbatojnë rregullat përkatëse të së drejtës procedurale dhe materiale (shih, GJEDNJ rasti *Perlala kundër Greqisë*, paragrafi 25 dhe *Khan kundër Mbretërisë së Bashkuar*, paragrafi 34, dhe shih, gjithashtu rastet: KI70/11, parashtrues të kërkesës *Faik Hima, Magbule Hima dhe Besart Hima,* Aktvendim për papranueshmëri, i 16 dhjetorit 2011; dhe KI56/17, parashtruese e kërkesës *Lumturije Murtezaj*, Aktvendim për papranueshmëri, i 18 dhjetorit 2017, para. 41).

31. Roli i Gjykatës Kushtetuese është që të sigurojë pajtueshmërinë me të drejtat e garantuara me Kushtetutë dhe instrumentet e tjera ligjore. Prandaj, Gjykata Kushtetuese nuk mund të veprojë si "gjykatë e shkallës së katërt" (shih rastin e GJEDNJ-së, *Akdivar kundër Turqisë*, nr. 21893/93, GJEDNJ, Aktgjykimi i 16 shtatorit 1996, para. 65; shih po ashtu, *mutatis mutandis*, Aktvendimin për papranueshmëri të Gjykatës Kushtetuese, rasti KI86/11, me parashtrues *Milaim Berisha,* i 5 prillit 2012).

32. Gjykata vëren se parashtruesi i kërkesës thjeshtë nuk pajtohet me rezultatin e procedurës para gjykatave të rregullta. Megjithatë, pakënaqësia e parashtruesve të kërkesës me rezultatin e procedurës nga gjykatat e rregullta nuk mund vetvetiu të ngrejë pretendim të argumentueshëm për shkeljen e të drejtave kushtetuese (shih, *mutatis mutandis,* rastin *Mezotur - Tiszazugi Tarsulat kundër Hungarisë*, paragrafi 21, GJEDNJ, Aktgjykimi i 26 korrikut 2005; shih Aktvendimin për papranueshmëri të Gjykatës Kushtetuese, në rastin: KI25/11, me parashtrues *Shaban Gojnovci,* të 28 majit 2012, paragrafi 28; shih, gjithashtu rastin KI56/17, parashtruese e kërkesës *Lumturije Murtezaj*, Aktvendim për papranueshmëri, i 18 dhjetorit 2017, paragrafi 42).

33. Për më tepër, Gjykata vëren se, Gjykata Supreme arsyetoi pretendimin e parashtruesit të kërkesës, përkitazi me faktin se vendimet gjyqësore u mbështetën në një provë të vetme, duke arsyetuar:

> *"Gjykata Supreme konstatoi se pretendimet e këtilla nuk janë të bazuara, jo vetëm për arsye se të dënuarit B. Z. dhe L. H. në shqyrtimin kryesor e kanë pranuar fajësinë për veprat penale të kryera në bashkëkryerje me këtë të dënuar, por ata në hetuesi kanë përshkruar dukjen e tij si dhe automjetin me të cilin e ka bërë transportin ...".*

34. Më tej, Gjykata Supreme, arsyeton:

> *"Në anën tjetër dëshmia e dëshmitarit Z. R. polic në Stacionin e Policisë në Skenderaj, ka rrjedhur ... se të dënuarit gjatë dhënies së deklaratave të tyre kanë deklaruar se ky person e ka një shenjë në dorë (nga djegia) dhe në bazë të këtyre deklaratave hetuesit policor kanë bërë identifikimin e të dënuarit dhe automjetit të tij".*

35. Në këtë këndvështrim, Gjykata konsideron se pretendimeve të parashtruesit të kërkesës, të cilat ai i ka ngritur në Gjykatë, iu është përgjigjur Gjykata Supreme duke arsyetuar ato gjerësisht dhe veç e veç në vendimin e saj.

36. Gjykata rithekson se për një proces gjyqësor të natyrës penale është e rëndësishme nëse i akuzuari dhe mbrojtësi i tij kanë pasur mundësi për t'i kundërshtar argumentet të cilat shkojnë në dëm të të akuzuarit, për t'iu parashtruar pyetje dëshmitarëve gjatë dëgjimit publik dhe për të pasur mundësinë e përdorimit të mjeteve ligjore, kundër çdo akuze të ngarkuar, në pajtueshmëri me kërkesat e nenit 30 dhe 31 të Kushtetutës, në lidhje me nenin 6 të Konventës. Në këtë kontekst, Gjykata konsideron se, si parashtruesi po ashtu edhe mbrojtësi i tij kanë pasur mundësi që gjatë gjithë procesit gjyqësorë t'i shfrytëzojnë këto mundësi pranë gjykatave të rregullta.

37. Andaj, nga si u tha më sipër, Gjykata vlerëson se parashtruesi i kërkesës, ka pasur mundësi të mjaftueshme që para gjykatave të rregullta t'i prezantoj të gjitha pretendimet për shkelje të të drejtave të tij. Për më tepër, Gjykata konsideron se argumentet e tij janë dëgjuar në mënyrë të rregullt dhe janë shqyrtuar në mënyrë të duhur nga gjykatat e rregullta. Andaj, Gjykata konsideron se vendimet e gjykatave të rregullta janë të arsyetuara dhe se procedurat, shikuar në tërësinë e tyre, nuk kanë qenë në ndonjë mënyrë të padrejta apo arbitrare (shih rastin e GJEDNJ-së *Shub kundër Lituanisë*, nr. 17064/06, Aktgjykim i 30 qershorit 2009).

38. Si përfundim, Gjykata konsideron se kërkesa, në baza kushtetuese është qartazi e pabazuar, sepse parashtruesi i kërkesës nuk dëshmon dhe mbështetë në mënyrë të mjaftueshme pretendimin e tij për shkeljen e të drejtave të garantuara me Kushtetutë dhe Konventë.

39. Rrjedhimisht, Gjykata konkludon se kërkesa është qartazi e pabazuar në baza kushtetuese dhe, në pajtim me rregullin 39 (2) të Rregullores së punës, ajo duhet të deklarohet e papranueshme.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese, në mbështetje të nenit 113.7 të Kushtetutës, të nenit 20 të Ligjit dhe të rregullave 39 (2) dhe 59 (b) të Rregullores së punës, më 30 janar 2019, njëzëri

VENDOS

I. TË DEKLAROJË kërkesën të papranueshme;

II. T'UA KUMTOJË këtë vendim palëve;

III. TË PUBLIKOJË këtë vendim në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit;

IV. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtari raportues

Radomir Laban

Kryetarja e Gjykatës Kushtetuese

Arta Rama-Hajrizi